



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 07/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Ymer Hoxha, anëtarë dhe me zyrtarin ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Vukoje Vukojeviç nga radhët e subjektit politik Aktivna Gradjanska Inicijativa (AGI), paraqitur kundër vendimit nr.672/2017 i datës 24.05.2017, të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datën 25.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si e palejueshëm apeli i përfaqësuesit Vukoje Vukojeviç nga radhët e subjektit politik Aktivna Gradjanska Inicijativa (AGI) .

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 25.05.2017, ka pranuar një apel nga Vukoje Vukojeviç nga radhët e subjektit politik AGI paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr.672/2017 i datës 24.05.2017, lidhur me certifikimin e koalicionit në mes të partive politike “Partija Kosovskih Srba-Aktivina Gradjanska Inicijativa”. Parashtruesi i apelit ka theksuar se kemi shkëputur koalicionin dhe ka shtuar se e kemi dorëzuar listën e kandidatëve nga radhët e subjektit politik Aktivna Gradjanska Inicijativa (AGI) për tërheqjen e kandidatëve për deputet.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në, më datën 25.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datë 25.05.2017 deri në ora 17:00.

PZAP-i, ka pranuar përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja, duke theksuar se KQZ-ja ka pranuar kërkesën e kryetarit të partisë politike Aktivna Gradjanska Inicijativa me datën

23.05.2017, për tërheqjen e kandidatëve të koalicionit Partija Kosovskih Srba-Aktivina Gradjanska Inicijativa, e cila kërkesë mban numrin e protokilit nr.533/2017, dhe se për këtë është njoftuar kryetari i partisë si pjese e koalicionit. Po ashtu KQZ-ja, në mbledhjen e datës 23.05.2017, ka marr vendim që të certifikoj të gjitha subjektet dhe kandidatët e tyre të përkatësisë shqiptare, ndërsa subjektet politike përkatëse etnike joshqiptare janë certifikuar por pa kandidatët e tyre dhe se KQZ-ja ka certifikuar kandidatët të cilët kanë mbetur në listën e koalicionit Partija Kosovskih Srba-Aktivina Gradjanska Inicijativa me datën 24.05.2017, ndërsa kandidatët të cilët kryetari i Aktivina Gradjanska Inicijativa ka kërkuar që të largohen nga lista, janë larguar sipas afatit të paraparë ligjorë.

PZAP-i, pasi që ka analizuar lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli i PZAP-it, në këtë rast nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e kësaj çështje, pasi që sipas kërkesës së parashtruar në KQZ nga subjekti politik AGI, për të njëjtën nuk është marr vendim nga KQZ, ndërsa në PZAP, mund të parashtrohen apele ndaj vendimeve të KQZ-së, vetëm sipas nenit 122 të LZP-së. Ankuesi në njoftimin “ankesën” vetëm e ka njoftuar PZAP-in se ka parashtruar kërkesë në KQZ, lidhur me tërheqjen e listës së kandidatëve për deputet.

Andaj nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 paragrafi 5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 07/2017 më datën 25.05.2017



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.